




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR



Nr. 621/ 637 regjistri, datë 4./ 7.4.2014.
Nr. 146 vendimi, datë 25.2.2015.

V E N D I M
N Ë
“EMËR TË REPUBLIKËS”

Unë Ahmet JANGULLI/ GJYQAR në gjykatën administrative të shkallës së parë Shkodër, në Shkodër në datën 25.2.2015, shqyrtova në seancë përgatitore çështjen administrative nr.621/ 637 akti, që u përket palëve :

Paditëse :

Firma SH.R.S.F. “STUDENTI” (pa dokument identifikimi/ ekstrakt QKR je), me drejtues ligjor z. Mark Gjini (pa dokument identifikimi/ letërnjoftimi).

E paditur :

Drejtoria rajonale tatimore Shkodër.

E përfaqësuar në gjykim/ me shkresën nr.2795 prot datë 17.4.2014, nga juristja zj Sirjana Bakushi/ e njohur me letërnjoftimin me nr.024589376 e me nr. personal H75426117F.

Objekti :

Kerkese Gjykatës Administrative Shkodër: Hedhje poshtë (ç’fuqizim) të aktit administrative nr.10455/3 datë 6.12.2013 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për mos deklarim të një punonjësi për shumën 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

B. Ligjore :

Në zbatim të ligjit nr.9920 datë 18.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” kreu XII Ankimi Administrativ, neni 109 i udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24 datë 2.9.2008.

Gjatë gjykimit, në mungesë të palëve, e si shqyrtova aktet shkresore në tërësi.

KONSTATOVA

I.

1. Se, pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me kërkesëpadi/ duke pretenduar sipas objektit.

1.1. padia është regjistruar *pa u paguar* taksa mbi aktet/ e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

II. Rrethanat e faktit:

2. Palët me njeri tjetrin, janë në një konflikt, për veprimet administrative të kryera gjatë mbajtjes së aktit dhe gjatë shqyrtimit të ankimit administrativ.

2.1. pala paditëse ka vënë në lëvizje gjykatën me padi/ duke pretenduar sipas objektit të mësipërm, duke paraqitur para gjykatës/ **padinë e mësipërme** (bëhet fjalë për padinë e paraqitur për regjistrim), dhe duke bashkëngjitur asaj/ aktet përkatëse.

2.2. në aktet shkresore, që i janë bashkëngjitur padisë, akti administrativ objekt gjykimi, është paraqitur me vule të sekretarisë, pa shkresë përcjellëse të organit publik përkatës nga ka dalë; duke i hequr mundësinë gjykatës, për t'a marrë në shqyrtim (akti, në fashikull).

3. Çështja (padia) është paraqitur për gjykim në datën 4.4.2014. Në zbatim të ligjit procedural civil – administrativ/ gjykata ka vendosur që të regjistrohet padia e bashkë me regjistrimin të paguhet edhe taksa mbi aktet e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore.

4. Në datën 21.1.2015/ çështja ka kaluar për veprime përgatitore, duke thirrur edhe palët për t'i dëgjuar.

4.1. në *seancë*, pala paditëse nuk u paraqit/ pa ndonjë shkak të arsyeshëm, ndonëse kishte dijeni të rregullt, dhe në këto rrethana gjykimi u zhvillua në mungesë të saj.

4.2. në veprimet përgatitore/ në seancën e datës 21.1.2015, kërkesëpadia i është kthyer palës paditëse për t'a plotësuar atë në elementët e saj të nevojshëm;

4.2.1. që kërkojnë nenet 154 e 156 të k.pr.civile, e konkretisht/ në lidhje me:

identifikimin e aktet identifikuese për palët ndërgjyqëse, adresën (vendbanimin ose vendqëndrimin) e palës paditëse, palës së paditur, dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ato, objektin, tregimin e fakteve, rrethanave, dokumenteve, mjeteve të tjera provuese, të drejtën mbi të cilën mbështetet kërkitimi, dhe kërkitimin (*me fjalë të tjera, duhen identifikuar palët ndërgjyqëse, duhet përcaktuar adresa (vendbanimi ose vendqëndrimi) i palëve, dhe i personave që përkatësisht i përfaqësojnë ato, duhet përcaktuar objekti, duhet orientuar kërkitimi, në mbështetje të shkakut ligjor, nëse jeni para këtij kërkitimi, para kësaj ndërgjyqësie në kuptimin procedural e material, mënyra e kërkitimit të së drejtës, duhet parashtruar fakti si për të drejtën tuaj ashtu dhe për të drejtën e shkelur nga ana e palës së paditur, dhe kërkitimin e konkluduar*), kopje të kërkesë padisë e të akteve provuese për të drejtën çfarë kërkohet, për palët e aktorët që

marrin pjesë në çështje, dhe kur është paraqitur kërkesëpadia, nuk është paguar taksa mbi aktet/ e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore;

dhe,

4.2.2. që kërkon neni 21 i ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", e konkretisht/ në lidhje me:

adresën e palës paditëse ose të përfaqësuesit, në të cilën duhet t'i dërgohen nga gjykata njoftimet dhe aktet, e një numër telefoni të saj ose të përfaqësuesit, në të cilin gjykata mund ta njoftojë, një adresë elektronike të saj ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, si dhe deklaratën e pranimit të njoftimit me telefon ose në mënyrë elektronike;

sipas vendimit kthim për plotësim të datës 21.1.2015/ duke i lënë një afat kohor prej 5 ditësh, dhe për këtë arsye u ndërprejnë veprimet përgatitore (për më shumë p-v).

5. Për vendimmarrjen e mësipërme/ paditësi ka marrë dijeni në datën 12.2.2015, dhe në afatin që i është lënë në vendimmarrje, nuk ka paraqitur para gjykatës/ padi të plotësuar në elementët e saj.

6. Kërkesëpadia është po ajo që ishte, pala paditëse nuk ka plotësuar asgjë në të, atë çfarë i ishte kërkuar si më sipër, dhe afati që i ishte lënë për plotësim ka kaluar.

III. Legjislacioni i zbatueshëm:

7. Kodi i Procedurës Civile:

Neni 14.

Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Neni 154

Kërkesëpadia shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të përmbajë:

...

Neni 156

Aktet që i bashkëngjiten padisë

Bashkë me kërkesëpadinë duhet të paraqiten:

...

8. Ligji nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative":

Neni 21

Padia dhe aktet që i bashkëlidhen

1. Padia duhet të plotësojë kërkesat e neneve 154 e 156 të Kodit të Procedurës Civile.

...

9. **Vendimi i njësuar nr.9 datë 9.3.2006** i kolegeve të bashkuara të gjykatës së Lartë/ në të cilin është parashikuar:

“...
Në përfundim, mund të theksojmë se neni 154 i K.Pr.Civile përcakton në mënyrë analitike elementët përbërës të kërkesëpadisë si mjeti procedural që vë në lëvizje gjykatën për fillimin e gjykimit të një çështjeje civile. Një kërkesë padi që nuk i plotëson këto elementë të domosdoshëm është e papranueshme për t’iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor, prandaj i kthehet paditësit për t’u plotësuar në respektim të rregullave procedurale.”.

10. E drejta/ materiale e procedurale, civile - administrative, në të cilën është parashikuar :

IV. Vlerësimi i gjyqtarit:

11. Në vlerësimin tonë:

11.1. kërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor, është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe afatet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (neni 3/ për nenet 154 e 156 të k.pr.civile). Të njëjtën gjë citon edhe praktika gjyqësore e gjykatës së Lartë (po përmendim/ vendimin civil nr.768/1 datë 15.9.2011 të gjykatës së Lartë).

11.2. konsiderohet se/ për procesin e filluar gjykata i ka mbaruar detyrimet e saja/ në drejtim të orientimit të procesit, dhe në drejtim të kohës së duhur që i ka lënë në dispozicion palës që ka vënë në lëvizje gjykatën/ për të plotësuar kërkesëpadinë në të metat e saj.

11.3. kërkesëpadija është e pa plotësuar në elementët e saj, pasi nisur nga gjendja e kërkesëpadisë së paraqitur/ e nisur nga gjendja e saj në seancë, asaj i mungojnë:

“të dhënat që duhet të përmbajë/ e që duhet të tregojë, dhe jo më të bëhet fjalë për provat/ aktet provuese që duhet t’i bashkëngjiten asaj” (nenet 154 e 156 të k.pr.civile, dhe neni 21 i ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”).

11.4. në këtë gjendje, gjykata e ka të pamundur që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor e që të japë një zgjidhje të drejtë e përfundimtare për konfliktin/ mosmarrëveshjen midis palëve.

11.5. bashkë me regjistrimin e padisë duhen paguar edhe taksa mbi aktet/ e shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore (nenet 154 e 156 të k.pr.civile).

12. Në këto kushte, e çmova se/ kërkesëpadija duhet t’i kthehet palës paditëse, së bashku me aktet e tjera.

13. Në këtë zgjidhje gjykata është bazuar:

në nenet 42 e 145 pika 1 të kushtetutës së ndryshuar, në nenin 6 të kësaj së, në ligjin nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", e në të drejtën/ materiale e procedurale, civile - administrative.

Sa sipër provohet me aktet shkresore dhe gjithë dokumentacioni në dosje.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 25 pika 1 gërma a) të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe të nenit 158 gërma a § 1 e 2/ për nenin 154 gërma a § 6/ për § 4 e 5 të k.pr.civile.


V E N D O S A

Kthimin e kërkesëpadisë/ në çështjen administrative nr.621/ 637-akti, datë 4/ 7.4.2014, që është ngritur nga pala paditëse firma SH.R.S.F. "STUDENTI", së bashku me aktet.

Shpenzimet gjyqësore t'i ngarkohen palës paditëse firma SH.R.S.F. "STUDENTI".

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë, në gjykatën administrative të apelit Tiranë.

U shpall në Shkodër me 2 shkurt 2015.




GJYQTAR
Ahmet JANGULLI

Shpenzimet gjyqësore:
Njoftime 500 lekë,
Akte – Letër 50 lekë,
Shuma: 550 lekë.

Sekretare
Entela HASMUJAJ

VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË. 24.03.2015



KANCELARE
BLERTA NURJA